



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

PËR MIRATIMIN E RITJES TË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E GRANTIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PËRFSHIRJE SOCIALE PËR NDRYSHIM” MIDIS BASHKISË KORÇË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP)

Në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të Mos Mbetet Pas” Bashkia Korçë ka aplikuar me projektin me temë : “ Përfshirje sociale për ndryshim” dhe ka përfituar një grant me vlerën 3,000,000 lekë. Kontributi i Bashkisë Korçë është kontribut në natyrë si burime njerëzore, qera salle e përllogaritur në vlerë totale 649,000 lekë.

Në vijim të realizimit të marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. 4818 Prot., datë 21.06.2023 midis Bashkisë Korçë dhe Programit Të Kombeve Të Bashkuara Për Zhvillim është çelur kësti i parë me shumën 1,800,000 lekë (60% e vlerës totale të projektit) me synim realizimin e aktiviteteve si më poshtë:

1 -Krijimi i rrjetit lokal të palëve të interesuara me vlerë totale 400,000 lekë.

Realizimi i këtij aktiviteti do të nisë me punë përgatitore nëpërmjet takimeve joformale ndërmjet palëve të interesuara dhe me takime formale për lançimin e projektit për të vijuar me trajnimin e personelit, në shtatë njësitë administrative dhe struktura e re e Drejtorisë së Kujdesit Social (SHMFF) (Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen)

2-Inicimi i një shërbimi të lëvizshëm për informimin dhe identifikimin e nevojave me vlerë totale 700,000 lekë.

Inicimi i këtij shërbimi lëvizës me punonjës social në funksion të krijimit të strukturave të NJRVN-ve (Njësitë e Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave) nëpërmjet realizimit të shtatë fokus

grupeve (një për secilën Njësi Administrative) me përfshirjen e 105 pjesëmarrësve të cilët do të informohen për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së SHMFF-së (Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjet) .

Në vijim të këtij aktiviteti do të hartohen dhe plotësohen 300 pyetësorë nëpërmjet intervistave në terren për mbledhjen e informacionit dhe identifikimin e nevojave specifike të fëmijëve dhe familjeve me qëllim realizimin e një studimi të mirfilltë për të identifikuar, adresuar dhe përmirësuar shërbimet në vijim.

3- Trajnime për nënat dhe fëmijët me vlerë 350,000 lekë

Janë parashikuar të realizohen pesë trajnime një ditore mbi prindërimin me qëllim rritjen dhe përmirësimin e aftësive prindërore të 70 nënave , duke siguruar një mjedis më pozitiv familjar, rrezik të reduktuar të braktisjes së shkollës dhe institucionalizimit për fëmijët e tyre.

Në këtë aktivitet, 70 fëmijë nga tre qendrat ditore komunitare të ngritura nga Bashkia Korçë do të marrin këshillim psikologjik për një periudhë tre mujore, me synim përmirësimin e problemeve të shëndetit mendor, uljen e rrezikut të braktisjes së shkollës, institucionalizimit dhe përmirësim të mirqënies emocionale dhe rezultate më të mira.

4-Trajnim profesional për të rinjtë dhe për orientimin drejt kërkesave të tregut me vlerë 350,000 lekë.

Realizimi i këtij aktiviteti konsiston në trajnimin e 15 të rinjve të moshës 16-18 vjeç në fushën e ITC-së duke identifikuar aftësitë dhe interesat e gjithsecilit për ti orientuar drejt rrugës së duhur me aftësi të rritura drejt mundësive të punësimit duke iu mundësuar një shans të mirë në arritjen e stabilitetit dhe pavarësisë afatgjatë.

Gjatë gjithë aktiviteteve do të mundohet të ruhet balanca gjinore, por kjo nuk varet vetëm nga projekti por edhe nga target grupet që përshkaten me specifikën e aktiviteteve të tij.

Secili prej këtyre aktiviteve do të ofrohet nga subjekte me ekspertë të fushës duke kaluar procedurat e prokurimit sipas ligjit Shqiptar.

Për të gjitha këto arsye, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë miratimin e grantit prej 1,800,000 lekësh dhe përdorimin e tij si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

1 -Krijimi i rrjetit lokal të palëve të interesuara me vlerë totale 400,000 lekë

2-Inicimi i një shërbimi të lëvizshëm për informimin dhe identifikimin e nevojave me vlerë totale

700,000 lekë

3- Trajnime për nënat dhe fëmijët me vlerë 350,000 lekë

4- Trajnim profesional për të rinjtë dhe për orientimin drejt kërkesave të tregut me vlerë 350,000 lekë

Programi Përkujdesi Social

SHTOHET AI122 Prod. V043AAI 00 Art. 6020000 05 +1,800,000 lekë

Duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve, si dhe marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. 4818 Prot., datë 21.06.2023 midis Bashkisë Korçë dhe Programit Të Kombeve Të Bashkuara Për Zhvillim, kërkojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak, miratimi i grandit në vlerën 1,800,000 lekë dhe përdorimi i tij si më sipër.

*Drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Drejtoresha e Kujdesit Social

*Drejtoresha e Drejtorisë
së Përgjithshme të Financës,
Buxhetit dhe MFK*

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Mariana JORGJI

Valbona ZIKO

*Kryetari i Bashkisë
Sotiraq FILO*

